

**Njoftim për përqendrim ndërmjet Longtejl Ad Solushens, Inc SHBA dhe Shoqërisë për Teknologji Informatike INPLEER HUB SHPKNJP Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe InPleer Limited, Mbretëria e Bashkuar.**

**(Lënda nr. 08-137/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 10.10.2022, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga **Longtejl Ad Solushens, Inc** (Longtail Ad Solutions, Inc), me seli të regjistruar në shtetin e Delaver në 251 Litll Folls Drayv, Vilmington, Rrethi Nju Kasl 19808, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbi **Shoqërinë për Teknologji Informatike INPLEER HUB SHPKNJP Shkup** me seli në rr. Nikolla Klusev nr. 11, Qendër, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe mbi disa mjete të InPleer Limited (InPlayer Limited), me seli në 37-41 Mortimer Street, Londër, VV1T 3JH, Mbretëria e Bashkuar, përmes blerjes së pjesëve dhe mjeteve.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

**Longtejl Ad Solushens** është shoqëri udhëheqëse e grupit të shoqërive JV Pleer (JV Player). JV Pleer ofron teknologjinë për riprodhimin online (*online video player technology*) të videove sipas kërkesës dhe shikimin e videove në mënyrë të drejtpërdrejtë, e cila u shitet botuesve online dhe transmetuesve në bazë të softuerit si shërbim (SaaS). Longtejl nuk është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka gjeneruar të ardhura (direkt ose indirekte) në vend.

Aktiviteti kryesor afarist i **INPLEER HUB SHPKNJP Shkup** është zhvillimi i softuerit. Më konkretisht, INPLEER HUB SHPKNJP Shkup merr pjesë në zhvillimin dhe funksionimin e platformës InPlayer për fitim parash nga video, që përfshin ofrimin e shërbimeve mbështetëse për përdoruesit e platformës.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si tregu i zgjidhjeve dhe shërbimeve të TI-së.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

10.10. 2022

Shkup